



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:048100

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05459312

P.nr. 79/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit A. S. dhe të pandehurës M. H., për shkak të veprës penale secili veç e veç "Dhuna në familje" nga neni 248 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.138/24F, të datës 26.02.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar të mbyllur për publikun, të mbajtur me datë 08.03.2024, në të cilin ishin të pranishëm prokurori i shtetit Besart Mustafa, e dëmtuara Sh. A., i pandehuri i parë dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av. F. K. dhe e pandehura M. H., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 11.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1. A. S., nga i ati N. dhe nëna F., mbiemri i vajzërisë së nënës R., data e lindjes ..., në fshatin B., Komuna P., ndërsa me vendbanim në rrugën "...", blloku ..., nr. ... F. K, letërnjoftimi ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion taksist privat, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim nga data 11.02.2024, deri me datë 08.03.2024, i gjykuar më parë për vepra tjera penale.

2. M. H., nga i ati S. dhe nëna S., mbiemri i vajzërisë së nënës L., data e lindjes ..., në fshatin S., Komuna P. ku edhe tani jeton, letërnjoftimi ..., ka të kryer shkollën fillore, me profesion amvise, e pa martuar, nënë e një (1) fëmijë, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Sepse:

1. I pandehuri A. S.

I. Me datë 06.02.2024 rreth orës 23:00 në shtëpinë e familjes së bashkëshortes së tij të dëmtuarës Sh. A. që gjendet në fshatin S., Komuna e P., i pandehuri A. S. me dashje dhe me qëllim të cenimit të dinjitetit të të dëmtuarës bashkëshortes se tij Sh. A. pas një mosmarrëveshje verbale mes tyre që kishte ndodhur rrugës gjatë kthimit nga P. në F. K. për shkaqe xhelozie dhe e dëmtuara kishte dal nga vetura e të pandehurit dhe ishte kthyer prapë tek familja e saj në

fshatin S., i pandehuri ka shkuar prapë tek familja e të dëmtuarës ku pasi që fillimisht i bërtet pse është kthyer aty se nuk është dashur të del nga vetura pa lejen e tij se ajo është gruaja e tij dhe duhet me dëgjua atë dhe kështu duke qenë nervoz e sulmon fizikisht të dëmtuarën duke e goditur me grushte disa here në kokë, fytyrë dhe në dorën e majtë dhe atë në prezencë të nënës së saj e cila ndërhyrë për ta ndarë të pandehurin nga vajza e saj, ku edhe pas katër ditësh shihen shenja të dhunës fizike, kur e dëmtuara e raporton rastin në polici, me ç' rast, tek e dëmtuara ka shkaktuar shqetësim të madh emocional, ankth, frikë dhe pasiguri për jetën e saj,

- me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale "Dhuna në familje" nga neni 248 par. 1 të KPRK-së.

2. E pandehura M. H.

II. Më dt.10.02.2024 diku rreth orës 23:00 në fshatin S., Komuna e P. në shtëpinë e saj familjare e pandehura M. H. me qëllim të cenimit të dinjitetit të të dëmtuarës vajzës së saj Sh. A. pas një mosmarrëveshje verbale mes tyre rreth kthimit të së dëmtuarës tek bashkëshorti i saj dhe duke i bërë presion psikik që ajo të kthehet dhe të pajtohet prapë me burrin e saj A. për ndryshe do ta largon nga shtëpia e saj dhe se nuk ka vend aty për te me fjalët "**nëse ndahesh kam me të largua nga shtëpia**" dhe kur e dëmtuara Sh. e kupton nga biseda telefonike e nënës së saj me A. se ai ishte duke u kthyer nga Sh. dhe do të shkonte tek shtëpia e tyre ajo nga frika se do ta rrahë prapë si herën e kaluar dhe se tani edhe nëna ishte në anën e tij dhe do ta largonte nga shtëpia, me ç' rast, tek e dëmtuara ka shkaktuar shqetësim të madh emocional, ankth, frikë dhe pasiguri për jetën e saj dhe e raporton rastin në polici.

- me këtë e pandehura ka kryer veprën penale "Dhuna në familje" nga neni 248 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 79 të KPRK-së, si dhe neneve 242, 364, 367 dhe 449 të KPPK-së, të pandehurit i:

G J Y K O N

1. Të pandehurin A. S.;

I. ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej dyqind (200) Euro dhe DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej njëqind e njëzet (120) ditësh, të cilat dënime do të ekzekutohen në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Koha e kaluar në paraburgim, të pandehurit do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

2. Të pandehurën M. H.;

III. ME DËNIM ME KUSHT, ashtu që i shqipton dënim me gjobë në shumë prej dyqind (200) Euro dhe i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditësh, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e pandehura nuk kryen vepër tjetër penale.

IV. DETYROHEN të pandehurit që në emër të shpenzimeve paushalle secili veç e veç të paguajë shumën prej njëzet (20) Euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit po ashtu shumën prej njëzet (20), në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

V. E dëmtuara Sh. A., me vendbanim në fshatin S., Komuna P., nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.138/24F, të datës 26.02.2024, kundër të pandehurit A. S. dhe të pandehurës M. H., për shkak të veprës penale secili veç e veç “Dhuna në familje” nga neni 248 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 08.03.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi bindet se të pandehurit e kuptojnë aktakuzën, në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së, të njëjtëve u ka ofruar mundësinë e deklaramit rreth fajësisë - të pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar apo të deklarohen të pafajshëm.

I pandehuri A. S., në seancën e shqyrtimit fillestar, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka shprehur keqardhje për ngjarjen e cila ka ndodhur mes tij dhe bashkëshortes së tij tani të dëmtuarës Sh. A., ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, ndërsa nga gjykata ka kërkuar që t'i shqiptojë një sanksion më të butë penal.

E pandehura M. H., në seancën e shqyrtimit fillestar ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka shprehur keqardhje për veprimet e që sipas sa i ka ndërmarrë me qëllim të mirë për vajzën e saj të vetme tani të dëmtuarën, që e njëjta të bashkohet dhe të jetojë me bashkëshortin e saj tani të pandehurin, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale dhe nga gjykata ka kërkuar që t'i shqiptojë një sanksion më të butë penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se të pandehurit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të njëjtët, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimi të fajësisë nga të pandehuri, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit dhe të dëmtuarës.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve sepse pranimi i fajësisë është bërë me vullnetin e tyre të plotë dhe në pajtim me dispozitat ligjore të KPPK-së, ndërsa me rastin e caktimit të sanksionit penal ka propozuar që gjykata të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të pandehurit t'i shpallë fajtorë dhe dënojë sipas ligjit.

Mbrojtësi i të pandehurit A. S. av. F. K., lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij pasi që pranimi i fajësisë nga i njëjti është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me të si mbrojtës, nga gjykata ka kërkuar që me rastin e caktimit të sanksionit penal të ketë për bazë rrethanat lehtësuese siç janë pranimi i fajësisë

në këtë fazë, shfaqjen e pendesës për veprën penale të cilën e ka kryer, gjendjen e dobët ekonomike, të njëjtit t'i shqiptojë një sanksion më të butë penal.

E dëmtuara Sh. A. është pajtuar me pranimin e fajësisë nga i pandehuri bashkëshorti i saj, e njëjta ka pohuar se e bartë një pjesë të përgjegjësisë për ngjarjen e natës kritike, nga gjykata ka kërkuar që të pandehurin ta lirojë për arsye se me të njëjtin dëshiron t'i rregullojë raportet dhe të bashkëjetojë, ndërsa ka deklaruar se nuk parashton kërkesë pasurore juridike.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimit të fajësisë nga të pandehurit si dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit dhe të dëmtuarës, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurve të ndërmarra në kuadër të dashjes së tyre, manifestohen elementet qenësore të figurës së veprës penale “Dhuna në familje” nga neni 248 par. 1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik janë përgjegjës, të njëjtit i shpalli fajtor dhe u shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që në rastin konkret si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, pajtimin në mes të pandehurit dhe të dëmtuarës, keqardhjen e shprehur, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese për të pandehurin A. S. gjykata mori parasysh faktin se nga të dhënat e siguruara nga evidenca penale rezulton se i njëjti ka qenë i gjykuar më parë për vepra tjera penale me vendim të formës së prerë të gjykatës dhe atë sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr.5265/2016, të datës 15.11.2019, për veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 275 të KPRK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumë prej pesëqind (500) euro dhe dënim me kusht, sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr.4502/2019, të datës 06.07.2020, për veprën penale “Vjedhja e rëndë” nga neni 253 të KPRK-së, i gjykuar me dënim me kusht, sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr.2382/2016, të datës 31.08.2021, për veprën penale “Ngacmimi” nga neni 186 të KPRK-së, i gjykuar me kusht, andaj mbi bazën e arsyeve dhe rrethanave të sipër theksuara vlerësoi se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi mundësinë e revokimit të dënimit me kusht është marrë në bazë të nenit 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi lirimin e të pandehurit për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në bazë të nenit 452 par. 4 të KPP-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko civil është marrë në bazë të nenit 462 par. 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr. 79/24, Datë 11.03.2024

Procesmbajtëse
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.